



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), Neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës për punën e Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar ndaj lëndës së formuar pas denoncimit të parashtruar, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në vazhdimin e seancës së 60-të, të mbajtur më 31.01.2022, miratoi si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numrin 12-198/1 e datës 14.01.2020, e cila shpreh pakënaqësi për punën e disa institucioneve shtetërore, **REFUZOHET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, nuk ka elemente për veprim kompetent n; rastin e lëndës, sepse e njëjta nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar gjatë ushtrimit të detyrave të autoritetit publik dhe detyrave zyrtare .

Lënda me numër 12-198/1 të datës 14.01.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 14.01.2020, është dorëzuar denoncim për pakënaqësi me punën e disa institucioneve shtetërore dhe është formuar lënda me numër 12-198/1 nga 14.01.2020.

Në denoncim ka pretendime për shkelje të së drejtës individuale, ku parashtruesi thekson se është ankuar në gjykatën ----- .

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK konstaton se në lëndë nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar në kryerjen e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare, d.m.th. pretendimet/veprimet e denoncuar nuk përbëjnë korrupsion në pajtim të definicionit të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 1 Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. KSHPK nuk ka juridiksion të veprojë ndaj lëndëve për të cilat është ngritur padi.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: S.M

Miratoi: Mr. SH.S anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ СХТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Nënkryetar
Goran Trpenoski

